OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRŽIŠTA KOSTT d.d
Nr. 39 Dt. 11 01 2023
PRISHTINË- A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Prishtinë, 11 janar 2023

ZYRA E RREGULLATORIT PER ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 015/23
Data. 11.01.23

10/23 101-KRK
1/1 11.01.2023

Nga: **Ymer Fejzullahu**, Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Për: **Z. Alpin Dogan,** Drejtor Menaxhues, KEDS Sh.A

**Z. Evetar Zeqiri**, Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT Sh.A

**Z. Serhat Dinç,** Drejtor Menaxhues, KESCO Sh.A

Kopje: **Z. Ferat Shala**, Kryetar Komisioni për zhvillim ekonomik, tregti dhe industri

**Znj. Artane Rizvanolli**, Ministre e Ekonomisë

**Z. Ismet Krasniqi,** Sekretar i Kuvendit të Kosovës

**Lënda: Shqyrtim i Jashtëzakonshëm i Të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorët e Rregulluar**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), më datë 5 dhjetor 2022, ka pranuar nga KEDS Sh.A dhe KESCO Sh.A kërkesën për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU).

ZRRE konform mandatit të saj dhe në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të sigurisë së furnizimit me energji elektrike ka analizuar të dhënat aktuale të operatorëve dhe bazuar në ato konstaton se është arritur pragu i materialitetit i përcaktuar në Rregullat e të Hyrave për operatorët e rregulluar, përkatësisht janë plotësuar kushtet për hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm. Shkaktarët kryesor për tejkalimin e pragut të materialitetit bazohen në mungesën e të hyrave të realizuara dhe të kostove më të larta të energjisë me shumicë krahasuar me ato të parashikuara.

Siç janë të njoftuar tanimë të gjitha palët e interesit, ZRRE në maj të vitit 2022 ka iniciuar procesin e shqyrtimit periodik për periudhën e tretë rregullative 2023 -2027. ZRRE procesin e shqyrtimit periodik do ta vazhdojë paralelisht me procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, dhe varësisht nga rrethanat do të shikojë mundësin e trajtimit të tij në kuadër të kuadër të një procesi. Marrë parasysh pa-parashikueshmeritë në tregjet e energjisë me shumicë në Evropë, të cilat reflektohen edhe në tregun e brendshëm të energjisë elektrike në Kosovë, ZRRE do të ndërmerr veprimet e duhura në harmoni me legjislacionin për sektorin e energjisë ashtu që të mos cenohet siguria e furnizimit me energji elektrike.

Në harmoni me Rregullat e të Hyrave, ZRRE fton operatorët e rregulluar KOSTT (OST/OT), KEDS (OSSh) dhe KESCO (FSHU) që të paraqesin kërkesat e tyre lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale brenda njëzetë (20) ditë pune nga pranimi i këtij njoftimi.

Me respekt,

Ymer Fejzullahu
Kryesues i Bordit të ZRRE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI • ENERGY REGULATORY OFFICE • REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

KEDS - SH.A.
Nr. 116 Dt. 11 JAN 2023
PRISHTINË/A 1

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njësia Org. 01 Nr. Prot. 164
Nr. i faqeve 1 Data: 11.01.23
PRISHTINË/A NO.1

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (ish Ndërtesa e Fazitës) kati 2, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A
KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D
KESCO - SH.A.
Nr. 17 Dt. 11 JAN 2023
PRISHTINË 1